

2010/1

VENDIM

Nr .513, date 21.9.2000

PER DETYRIMIN E MJEKEVE, QE DUAN TE SPECIALIZOHEN

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te paragrafit te tete, te nenit 13, dhe te paragrafit te dyte, te nenit 38, te ligjit nr.8461, date 25.2.1999, "per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise", me propozimin e ministrit te Shendetesise dhe ministrit te Arsimit dhe Shkences, Keshilli i Ministrave

VENDOSI"

1. Mjeket e pergjithshem, te diplomuar ne fakultetin e Mjekesise, ne Universitetin e Tiranës kane te drejte te konkurrojne per specializim pasuniversitar ne mjekesi vetem pasi te kene punuar nje vit ne vendet e lira te punes ne rrethe, te percaktuar nga Ministria e Shendetesise dhe Instituti i Sigurimeve te Kujdesit shendetesor .

2. Kane te drejte te konkurrojne, pa permbushur detyrimin e mesiperem, ata mjeke te pergjithshem, qe kerkojne te specializohen ne deget "Mjek i familjes", "Mjek i shendetit publik", dhe "Anatomi Pathologjike".

3. Ngarkohen Ministria e Shendetesise dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences te nxjerrin aktet, ne zbatim te ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI Ilir Meta

2010/2

VENDIM

Nr.801, datë 29.9.2010

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.513, DATË 21.9.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DETYRIMIN E MJEKËVE QË DUAN TË SPECIALIZOHEN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr.513, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave "Për detyrimin e mjekëve që duan të specializohen".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

2010/3

VENDIM

Nr.1013, datë 10.12.2010

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PROVIMEVE (AKP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), mbi bazën e AVA-së, APRIAL-it dhe Drejtorisë së Provimit të Shtetit, të krijuar për herë të parë në kuadër të AKP-së.
2. AKP-ja është person juridik, publik dhe buxhetor, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
3. AKP-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve, të pranimit në shkollat e larta dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit, të pranimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit.
4. AKP-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm dhe organizohet në drejtori dhe sektorë.
5. Drejtori i përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, sipas kriterëve dhe procedurave të caktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit".
6. Drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve, specialistët dhe punonjësit e tjerë emërohen nga drejtori i përgjithshëm, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".
7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKP-së rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
8. AKP-ja kryen këto funksione kryesore:
 - a) Vlerëson dhe menaxhon arritjet e nxënësve, nëpërmjet zhvillimit të provimeve kombëtare dhe vlerësimit të jashtëm, me kampionim.
 - b) Kontribuon në hartimin e politikave të vlerësimit dhe të strategjive të zbatimit të tyre.
 - c) Analizon dhe interpreton, sipas standardeve bashkëkohore dhe kërkesave të grupeve të interesit, rezultatet e provimeve kombëtare dhe të vlerësimeve dhe i përpunon ato për publikim.
 - ç) Harton të dhënat shkollore dhe të maturës shkollore për pranimin e studentëve në shkollat e larta të vendit.
 - d) Përpunon të dhënat për provimet përfundimtare të mësuesve për shkallët e karrierës.

- dh) Kontribuon në hartimin e rregulloreve të provimeve kombëtare dhe të pranimeve.
- e) Krijon një sistem unik dhe transparent për përcaktimin e kandidatëve fitues në programet e studimit, sipas parimit meritë - preferencë.
- ë) Analizon të dhënat e procesit dhe realizon studime për përmirësimin e sistemit të pranimeve në arsimin e lartë publik dhe organizimin e provimit të shtetit.
- f) Menaxhon, implementon dhe mbikëqyr procesin kompleks që nga testimi i njohurive teorike e praktike të mësuesve dhe të profesioneve të tjera, si gjatë periudhës së testimit, ashtu edhe gjatë ushtrimit të profesionit e të mbikëqyrjes.
- g) Digjitalizon testet e hartuara nga Komisioni i Provimit të Shtetit dhe përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë për zhvillimin e provimit të shtetit, përmes teknologjisë digjitale.
- gj) Trajnon personelin organizues dhe mbikëqyrës të provimit të shtetit dhe publikon on-line programin orientues të këtij provimi.
- h) Bën shpalljen e rezultateve të provimit të shtetit;
- i) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arritjet e nxënësve në provimet kombëtare dhe vlerësimet për procesin e pranimit të maturantëve në shkollat e larta dhe për organizimin e provimit të shtetit.

9. AKP-ja është institucion qendror, që financohet nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

10. Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton:

- a) statutin dhe rregulloren e funksionimit të AKP-së;
- b) përbërjen e bordit këshillimor të AKP-së.

11. Numri i punonjësve të AKP-së të jetë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2010, do të përballohen nga buxheti i këtij viti, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

13. Për punonjësit, të cilët pas riorganizimit humbasin vendet e punës, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

14. Vendimet nr.135, datë 14.3.2007 e Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve dhe për shkrirjen e Qendrës Kombëtare Arsimore të Vlerësimit dhe Arritjeve", të ndryshuar, dhe nr.503, datë 16.4.2008 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë", shfuqizohen.

15. Ngarko hen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

2011/1

VENDIM

Nr.812, datë 10.11.2011

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROVIMIN E SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 dhe 13, shkronja "c" të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit, si më poshtë vijon:

- a) Për kandidatin që jep provimin për herë të parë 10 000 lekë;
- b) Për kandidatin që jep provimin për herë të dytë 12 500 lekë;
- c) Për kandidatin që jep provimin për herë të tretë 15 000 lekë;
- ç) Për kandidatin që jep provimin për herë të katërt 17 500 lekë;
- d) Për kandidatin që jep provimin për herë të pestë 20 000 lekë.

2. Tarifat për provimin e shtetit, të llogaritura sipas pikës 1 të këtij vendimi, arkëtohen para procesit të regjistrimit për provim, pranë bankave të nivelit të dytë ose zyrave të Postës Shqiptare, për Degën e Thesarit Tiranë, për llogari të Agjencisë Kombëtare të Provimeve.

3. Të ardhurat e arkëtuara nga tarifa për provimin e shtetit nga Agjencia Kombëtare e Provimeve derdhen 100% në buxhetin e Agjencisë.

4. Pjesa e të ardhurave që i takon Agjencisë Kombëtare të Provimeve evidentohet, autorizohet dhe përdoret me strukturë të veçantë buxhetore në kapitullin 05, "Të ardhurat e veta".

5. Të ardhurat që sigurohen nga këto tarifa menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe përdoren si më poshtë:

- a) për pagesën e anëtarëve të grupeve të hartimit të fondit të pyetjeve dhe të Komisionit të Provimit të Shtetit;
- b) për të mbuluar shpenzimet për organizimin dhe funksionimin e provimit të shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

2011/2

VENDIM

Nr.649, datë 14.9.2011

PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SPECIALITETEVE, NËNSPECIALITETEVE APO SPECIALITETEVE
PLOTËSUESE PËR PROFESIONET E RREGULLUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Shtojca 1

LISTA E SPECIALITETEVE, NËNSPECIALITETEVE APO SPECIALITETEVE PLOTËSUESE PËR PROFESIONET
E RREGULLUARA

I. PROFESIONI I MJEKUT TË PËRGJITHSHËM (PA SPECIALITETE)

II. PROFESIONI I STOMATOLOGUT (PA SPECIALITETE)

III. PROFESIONI I FARMACISTIT (PA SPECIALITETE)

IV. PROFESIONI I INFERMIERIT INFERMIERI E PËRGJITHSHME LOGOPEDI

TEKNIK LABORATORI IMAZHERI

V. PROFESIONI I FIZIOTERAPISTIT (PA SPECIALITETE)

VI. PROFESIONI I MAMISË (PA SPECIALITETE)

VII. PROFESIONI I VETERINERIT (PA SPECIALITETE)

VIII. PROFESIONI I ARKITEKTIT

ARKITEKTURË (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË) URBANISTIKË (DIPLOMË E
CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË)

IX. PROFESIONI I INXHINIERIT (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË)

INXHINIERI MEKANIKE-PROFILI KONSTRUKSIONE E MJETE LËVIZËSE

INXHINIERI MEKANIKE - PROFILI ENERGJETIKE

INXHINIERI MEKANIKE (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË)

INXHINIERI ELEKTRIKE-PROFILI ELEKTROENERGJETIKE

INXHINIERI ELEKTRIKE-PROFILI AUTOMATIZIM INDUSTRIE

INXHINIERI NDËRTIMI - PROFILI STRUKTURIST

INXHINIERI NDËRTIMI-PROFILI TRANSPORT INXHINIERI NDËRTIMI-PROFILI GJEOTEKNIK INXHINIERI MJEDISI-PROFILI TRAJTIM UJRASH INXHINIERI MJEDISI-PROFILI ENERGJI

INXHINIERI NDËRTIMI (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË)

INXHINIERI MJEDISI (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË) INXHINIERI HIDROTEKNIKE (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË)

INXHINIERI GJEODEZI (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË)

INXHINIERI GJEOLGJIKE-PROFILI GJEOLGJI INXHINIERIKE DHE HIDROGJEOLGJI INXHINIERI GJEOFIZIKE

INXHINIERI E BURIMEVE NATYRORE-PROFILI GJEOMATIKE GJEOLGJI (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË) GJEOFIZIKË (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË) INXHINIERI NAFTE (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË) INXHINIERI MINIERA (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË)

INXHINIERI E PROCESIVE KIMIKE

INXHINIERI NAVALE

X. PROFESIONI I MËSUESIT (DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË)

MËSUES PËR ARSIM FILLOR MËSUES PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT MËSUES PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË

XI. PROFESIONI I PUNONJËSIT SOCIAL (DIPLOMË E CIKLIT TË PARË OSE EKVIVALENTE ME TË APO DIPLOMË E CIKLIT TË DYTË OSE EKVIVALENTE ME TË).¹

¹ (Ndryshuar me VKM, Nr.827, dt. 07.10.2015, botuar në FLZ Nr.177, datë 14.10.2015)

2011/2.1

VENDIM

Nr. 827, datë 7.10.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 649, DATË 14.9.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË SPECIALITETEVE, NËNSPECIALITETEVE APO SPECIALITETEVE PLOTËSUESE PËR PROFESIONET E RREGULLUARA"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", dhe të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 163/2014, "Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 649, datë 14.9.2011, të Këshillit të Ministrave, në shtojcën 1 "Lista e specialiteteve, nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara", pas ndarjes X shtohet ndarja XI, me këtë përmbajtje:

"XI. Profesion i punonjësit social (diplomë e ciklit të parë ose ekuivalente me të apo diplomë e ciklit të dytë ose ekuivalente me të).".

2. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

2011/3

VENDIM

Nr.918, datë 28.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE, ME KONTRATË TË PËRKOSSHME, PËR PERIUdhËN 1 JANAR-15 QERSHOR 2012 DHE 15 SHTATOR-31 DHJETOR 2012, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2011-2012 dhe 2012-2013, për periudhën 1 janar-15 qershor 2012 dhe për periudhën 15 shtator-31 dhjetor 2012, të jetë 1 300 (një mijë e treqind) veta.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, sipas drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve jepet sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për vitin 2012, në shumën 39 078 000 (tridhjetë e nëntë milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në buxhetin e vitit 2012.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS Tabela nr.1

Kodi i institucionit Emërtimi i institucionit arsimor Punonjës me kontratë të përkohshme për muajin janar 15 qershor 2012 Punonjës me kontratë të përkohshme për periudhën 1 shtator 31 dhjetor 2012

1011002 Drejtoria Arsimore Rajonale Berat 51 51
1011006 Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër 37 37
1011007 Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës 72 72
1011008 Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan 91 91
1011009 Drejtoria Arsimore Rajonale Fier 72 72
1011011 Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastrë 21 21
1011015 Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë 60 60
1011018 Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës 32 32
1011020 Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë 32 32
1011033 Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër 76 76
1011035 Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë 131 131
1011036 Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë 53 53
1011038 Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë 65 65
1011088 Zyra Arsimore Kuçovë 14 14
1011089 Zyra Arsimore Skrapar 13 13
1011090 Zyra Arsimore Bulqizë 16 16
1011092 Zyra Arsimore Mat 28 28
1011096 Zyra Arsimore Krujë 26 26

1011100 Zyra Arsimore Gramsh 19 19
1011101 Zyra Arsimore Librazhd 34 34
1011102 Zyra Arsimore Peqin 13 13
1011105 Zyra Arsimore Lushnjë 57 57
1011106 Zyra Arsimore Mallakastër 15 15
1011109 Zyra Arsimore Përmet 12 12
1011110 Zyra Arsimore Tepelenë 18 18
1011111 Zyra Arsimore Devoll 13 13
1011112 Zyra Arsimore Kolonjë 8 8
1011117 Zyra Arsimore Pogradec 32 32
1011118 Zyra Arsimore Has 9 9
1011120 Zyra Arsimore Tropojë 16 16
1011121 Zyra Arsimore Kurbin 23 23
1011123 Zyra Arsimore Mirditë 16 16
1011124 Zyra Arsimore Malësia e Madhe 17 17
1011125 Zyra Arsimore Pukë 16 16
1011130 Zyra Arsimore Kavajë 31 31
1011132 Zyra Arsimore Delvinë 7 7
1011133 Zyra Arsimore Sarandë 14 14
1011159 Zyra Arsimore Kamzë, Tiranë 40 40
1300 1300

2013/1

VENDIM

Nr. 23, datë 9.1.2013

PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE, ME KONTRATË TË PËRKOSSHME, PËR PERIUDHAT 1 JANAR - 15 QERSHOR 2013 DHE 15 SHTATOR - 31 DHJETOR 2013, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2012-2013, për periudhat 1 janar - 15 qershor 2013 dhe 15 shtator - 31 dhjetor 2013, të jetë 1 500 veta.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, sipas drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore, dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve jepet sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Praktikantët, gjatë periudhës së kryerjes së praktikës profesionale, përfitojnë nga punëdhënësi, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%, të përlogaritur mbi pagën minimale 21 000 (njëzet e një mijë) lekë, miratuar me vendimin nr. 445, datë 11.7.2012 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

4. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për vitin 2013, në shumën 47 344 500 (dyzet e shtatë milionë e treqind e dyzet e katër mijë e pesëqind) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në buxhetin e vitit 2013.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS Tabela nr. 1

Kodi i institucionit Emërtimi i institucionit arsimor Punonjës me kontratë të përkohshme për periudhën Punonjës me kontratë të për periudhën

1011002 Drejtoria arsimore Rajonale 59 59

1011006 Drejtoria arsimore Rajonale 43 43

1011007 Drejtoria arsimore Rajonale 83 83

1011008 Drejtoria arsimore Rajonale 105 105

1011009 Drejtoria arsimore Rajonale 83 83

1011011 Drejtoria arsimore Rajonale 24 24

1011015 Drejtoria arsimore Rajonale 69 69

1011018 Drejtoria arsimore Rajonale 37 37

1011020 Drejtoria arsimore Rajonale 37 37

1011033 Drejtoria arsimore Rajonale 88 88

1011035 Drejtoria arsimore e Qytetit 153 153
1011036 Drejtoria arsimore e Qarkut 61 61
1011038 Drejtoria arsimore Rajonale 75 75
1011088 Zyra arsimore Kuçovë 16 16
1011089 Zyra arsimore Skrapar 15 15
1011090 Zyra arsimore Bulqizë 18 18
1011092 Zyra arsimore Mat 32 32
1011096 Zyra arsimore Krujë 30 30
1011100 Zyra arsimore Gramsh 22 22
1011101 Zyra arsimore Librazhd 39 39
1011102 Zyra arsimore Peqin 15 15
1011105 Zyra arsimore Lushnjë 66 66
1011106 Zyra arsimore Mallakastër 17 17
1011109 Zyra arsimore Përmet 14 14
1011110 Zyra arsimore Tepelenë 21 21
1011111 Zyra arsimore Devoll 15 15
1011112 Zyra arsimore Kolonjë 9 9
1011117 Zyra arsimore Pogradec 37 37
1011118 Zyra arsimore Has 10 10
1011120 Zyra arsimore Tropojë 18 18
1011121 Zyra arsimore Kurbin 27 27
1011123 Zyra arsimore Mirditë 18 18
1011124 Zyra arsimore Malësia e Madhe 20 20
1011125 Zyra arsimore Pukë 18 18
1011130 Zyra arsimore Kavajë 36 36
1011132 Zyra arsimore Delvinë 8 8
1011133 Zyra arsimore Sarandë 16 16
1011159 Zyra arsimore Kamëz 46 46

Totali 1500 1500

2014/1

VENDIM

Nr. 231, datë 23.4.2014

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIUDHËN 1 JANAR - 15 QERSHOR 2014 DHE 15 SHTATOR 2014 - 31 DHJETOR 2014, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 57 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për vitin shkollor 2013-2014, për periudhën 1 janar - 15 qershor 2014 dhe periudhën 15 shtator 2014 - 31 dhjetor 2014, të jetë 1 500 veta.

2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme sipas drejtorive arsimore rajonale/zyrave arsimore dhe afati kohor i kontraktimit të punonjësve jepen sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Praktikantët, gjatë periudhës së kryerjes të praktikës profesionale, përfitojnë çdo muaj nga punëdhënësi, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7%, të përlogaritur mbi pagën bazë minimale mujore 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë, miratuar me vendimin nr. 573, datë 3.7.2013 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

Ndryshimet e pagës minimale mujore, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, reflektohen në masën e pagesës që punëdhënësi paguan çdo muaj për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

4. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2014, në shumën 49 599 000 (dyzet e nëntë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në buxhetin e vitit 2014.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2014.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

TABELA NR. 1

Kodi i institucionit Emërtimi i institucionit arsimor Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme sipas drejtorive arsimore Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale me kontratë të përkohshme sipas drejtorive arsimorë

1011002 Drejtoria Arsimore Rajonale 59 59

1011006 Drejtoria Arsimore Rajonale 43 43

1011007 Drejtoria Arsimore Rajonale 83 83

1011008 Drejtoria Arsimore Rajonale 105 105

1011009 Drejtoria Arsimore Rajonale 83 83

1011011 Drejtoria Arsimore Rajonale 24 24

1011015 Drejtoria Arsimore Rajonale 69 69

1011018 Drejtoria Arsimore Rajonale 37 37

1011020 Drejtoria Arsimore Rajonale 37 37

1011033 Drejtoria Arsimore Rajonale 88 88

1011035 Drejtoria Arsimore e Qytetit 153 153

1011036 Drejtoria Arsimore e Qarkut 61 61

1011038 Drejtoria Arsimore Rajonale 75 75

1011088 Zyra Arsimore Kuçovë 16 16

1011089 Zyra Arsimore Skrapar 15 15

1011090 Zyra Arsimore Bulqizë 18 18

1011092 Zyra Arsimore Mat 32 32

1011096 Zyra Arsimore Krujë 30 30

1011100 Zyra Arsimore Gramsh 22 22

1011101 Zyra Arsimore Librazhd 39 39

1011102 Zyra Arsimore Peqin 15 15

1011105 Zyra Arsimore Lushnjë 66 66

1011106 Zyra Arsimore Mallakastër 17 17

1011109 Zyra Arsimore Përmet 14 14

1011110 Zyra Arsimore Tepelenë 21 21

1011111 Zyra Arsimore Devoll 15 15

1011112 Zyra Arsimore Kolonjë 9 9
1011117 Zyra Arsimore Pogradec 37 37
1011118 Zyra Arsimore Has 10 10
1011120 Zyra Arsimore Tropojë 18 18
1011121 Zyra Arsimore Kurbin 27 27
1011123 Zyra Arsimore Mirditë 18 18
1011124 Zyra Arsimore Malësia e Madhe 20 20
1011125 Zyra Arsimore Pukë 18 18
1011130 Zyra Arsimore Kavajë 36 36
1011132 Zyra Arsimore Delvinë 8 8
1011133 Zyra Arsimore Sarandë 16 16
1011159 Zyra Arsimore Kamzë 46 46
TOTALI 1500 1500

2015/1

VENDIM

Nr. 197, datë 4.3.2015

PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PRAKTIKANTËVE PËR KRYERJEN E PRAKTIKËS PROFESIONALE, ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR PERIU DHËN 1 JANAR DERI NË 15 QERSHOR DHE 15 SHTATOR DERI NË 31 DHJETOR 2015, PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, për sistemin arsimor parauniversitar, për periudhën 1 janar - 15 qershor dhe periudhën 15 shtator - 31 dhjetor 2015, të jetë 1 500 veta.
2. Numri i praktikantëve për kryerjen e praktikës profesionale, me kontratë të përkohshme, sipas njësive arsimore vendore, dhe afati kohor i kontraktimit të tyre është sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Praktikantët, gjatë periudhës për kryerjen e praktikës profesionale, përfitojnë çdo muaj, nga punëdhënësi, njësitë arsimore vendore (drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore), pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7 %, të përlogaritur mbi pagën bazë minimale mujore 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë, miratuar me vendimin nr. 573, datë 3.7.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi". Ndryshimet në vendimin e Këshillit të

Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", reflektohen në masën e pagesës që punëdhënësi paguan, çdo muaj, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

4. Efektet financiare për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2015, në shumën 49 599 000 (dyzet e nëntë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të mbulohen nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2015 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2015.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Tabela nr. 1

Kodi i institucionit Emërtimi i institucionit arsimore (njësitë arsimore vendore) Numri i praktikantëve me kontratë të përkohshme për periudhën 1 janar - 15 qershor 2015 Numri i praktikantëve me kontratë të përkohshme për periudhën 15 shtator -31 dhjetor 2015

1011002 Drejtoria Arsimore Rajonale Berat 59 59

1011006 Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër 33 33

1011007 Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës 83 83

1011008 Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan 105 105

1011009 Drejtoria Arsimore Rajonale Fier 80 80

1011011 Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastër 24 24

1011015 Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë 80 80

1011018 Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës 30 30

1011020 Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë 30 30

1011033 Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër 88 88

1011035 Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë 177 177

1011036 Drejtoria Arsimore e Qarkut Tiranë 61 61

1011038 Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë 75 75

1011088 Zyra Arsimore Kuçovë 16 16

1011089 Zyra Arsimore Skrapar 15 15

1011090 Zyra Arsimore Bulqizë 15 15

1011092 Zyra Arsimore Mat 32 32
1011096 Zyra Arsimore Krujë 30 30
1011100 Zyra Arsimore Gramsh 22 22
1011101 Zyra Arsimore Librazhd 30 30
1011102 Zyra Arsimore Peqin 15 15
1011105 Zyra Arsimore Lushnjë 70 70
1011106 Zyra Arsimore Mallakastër 20 20
1011109 Zyra Arsimore Përmet 14 14
1011110 Zyra Arsimore Tepelenë 21 21
1011111 Zyra Arsimore Devoll 15 15
1011112 Zyra Arsimore Kolonjë 9 9
1011117 Zyra Arsimore Pogradec 50 50
1011118 Zyra Arsimore Has 10 10
1011120 Zyra Arsimore Tropojë 16 16
1011121 Zyra Arsimore Kurbin 20 20
1011123 Zyra Arsimore Mirditë 18 18
1011124 Zyra Arsimore Malësia e Madhe 20 20
1011125 Zyra Arsimore Pukë 16 16
1011130 Zyra Arsimore Kavajë 31 31
1011132 Zyra Arsimore Delvinë 8 8
1011133 Zyra Arsimore Sarandë 16 16
1011159 Zyra Arsimore Kamzë, Tiranë 46 46
TOTALI 1,500 1,500